



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të nenit 27.3 dhe nenit 55 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, në mbështetje të nenit 4 pika 6 të Rregullores së MF-Nr.02/2013-për Menagjimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Kryetari i Komunës së Deçanit, me dt.11.01.2018, merr këtë:


V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIM TË PASURISË JO FINANCIARE DHE INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE TË KOMUNËS SË DEÇANIT

- I. Themelohet Komisioni për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare dhe Inventarizim të Pasurisë jo Financiare të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:
 - 1.Xhevat Lufaj, Kryetar i Komisionit,
 - 2.Gani Cacaj, antar i komisionit,
 - 3.Shaban Pejqinoviç, antar i Komisionit,
 - 4.Dyke Llluni, antare e komisionit,
 - 5.Ibish Gërvalla, antar i komisionit,
 - 6.Zoje Selmonaj, antare e komisionit.
- II. Detyrat e Komisionit për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare dhe Inventarizim të Pasurisë jo Financiare janë:
 - Vlerësimi i pasurive që nuk kanë vlerë të bartur;
 - Vlerësimi i pasurive të dëmtuara të qitura jasht përdorimit dhe të atyre që nuk kanë mundësi të riparimit,
 - Vlerësimi dhe regjistrimi i të gjitha pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që i posedon organizata buxhetore (Komuna e Deçanit),
 - Vlerësimi i kërkesave eventuale për tjetërsim të pasurive si dhe prezentimin e deshmive për vlerësimin e pasurive .
 - Barazimi i gjendjeve aktuale me ato të kontabilitetit dhe konstatimi i diferencave eventuale, diferenca të cilat nëse konstatohen duhet të raportohen Menagjerit i cili do të marrë vendim për të dhe me shkrim të njoftohet kontabiliteti për vendimin e metejm.
 - Komisioni është i obliguar që regjistrimin, evidentimin dhe vlerësimin e pasurive ta bëjnë në bashkëpunim me Zyrtarin e pasurive të organizatës Buxhetore.
- III. Për punën e tyre anëtarët e Komisionit do të paguhën nga 150,00 € nga buxheti komunal.
- IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit.
- V. Me vendim njoftohen:
 - 1.Të emruarit në pikën I. të Vendimit,dhe
 - 2.Arhivi i KK Deçan.

02.Nr. .

Dt.11.01.2018



Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj

